



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Punehet/Prudato Received/Delivety	05. 08 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MBIK/04	4556/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.563/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca- anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.563/2022 të datës 24.06.2022, të parashtruar nga ankuesit :

i përfaqëson avokati _____ dhe _____ të cilët me autorizim kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pahazuar ankesa me numër A.nr.563/2022 e datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesit:

A r s y e t i m

Ankuesit

_____ dhe _____ të punësuar në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur me datën 28.04.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për pagesën e shujtave prej vitit 2017-2021. Pasi nuk kanë marrë përgjigje lidhur me kërkesën e datës 28.04.2022, ankuesit me datën 24.06.2022 përmes avokatit _____ kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 3688/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kompensimin e shujtës në mënyrë retroaktive prej vitit 2017-2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 08.07.2022 përmes e-mailit zyrtar kam kërkuar përgjigje në ankesë nga Menaxherja e Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me ankesën e ankuesve, ndërsa me datën 27.07.2022 kanë dërguar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 563/2022 të datës 24.06.2022 me numër protokollit 3688/2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 28.04.2022 për kompensimin e shujtave prej vitit 2017-2021; Akt emërimi i datës 01.05.2016; Vërtetimi i përvojës së punës; Autorizim i datës 08.03.2022; kopja e letërnjoftimit të Vërtetimi i përvojës së punës i datës 02.05.2014; Autorizimi i datës 08.03.2022; kopja e letërnjoftimit; Vërtetimi i përvojës së punës i datës 02.05.2014; kopja e letërnjoftimit; Autorizim i datës 08.03.2022; Vërtetimi i përvojës së punës 19.09.2015; kopja e letërnjoftimit; Autorizim i datës 08.03.2022; Vërtetimi i përvojës së punës i datës 02.05.2014; kopja e letërnjoftimit; Autorizim i datës 08.03.2022; Vërtetimi i përvojës së punës; kopja e letërnjoftimit; Vërtetimi i përvojës së punës; kopja e letërnjoftimit; Autorizimi i datës 08.03.2022; Vërtetimi i përvojës së punës; Autorizimi i datës 08.03.2022; Kopja e letërnjoftimit; Vërtetimi i Përvojës së punës; kopja e letërnjoftimit; Autorizim i datës 11.03.2022; E-mail zyrtar i datës 25.07.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 27.07.2022; Akt Emërimi i datës 01.01.2018; Akt emërimi i datës 01.05.2016; Akt emërimi i datës 01.05.2016; Akt emërimi i datës 01.05.2016; Akt emërimi i datës 01.01.2018; Akt emërimi i datës 01.05.2016 dhe Akt emërimi i datës 01.05.2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur që ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 01.01.2018 është e punësuar në pozitën Zyrtare për Financa, ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.05.2016 është e punësuar në pozitën Bashkëpunëtoreshë profesionale pedagogjike ;ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.05.2016 është e punësuar në pozitën Bashkëpunëtoreshë profesionale për administrim të Financave; ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.05.2016 është e punësuar në pozitën Bashkëpunëtoreshë profesionale për administrim të personelit; ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.01.2018 është e punësuar në pozitën Zyrtare e personelit; ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.05.2016 është e punësuar në pozitën Bashkëpunëtoreshë profesionale pedagogjike dhe ankuesja në bazë të Akt emërimit të datës 01.05.2016 është e punësuar në pozitën Asistente ekzekutive- të gjithë të punësuar në Agjencinë e Arsimit dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur.

Me tej ankuesit më datë 28.04.2022 kanë parashtruar kërkesë në Ministrinë e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë për kompensimin e shujtave ditore prej vitit 2017 deri në vitin 2021 sipas Kontratës Kolektive me Nr.24 të datës 18.04.2017 dhe kontratës kolektive të datës 22/01/2021 e lidhur me mesazhin të MASHT-it dhe SBASHK-ut.

Ankuesit pasi nuk kanë marrë përgjigje nga organi i punësimit ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor që ankuesve tu bëhet

kompensimi i shujtave ditore sipas Kontratës Kolektive me Nr.24 të datës 18.04.2017 dhe kontratës kolektive të datës 22/01/2021 e lidhur ne mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në pretendimet ankimore të palëve ka analizuar dispozitat e kontratave kolektive të potencuara si më lartë dhe konstaton se këto kontrata kolektive aplikohen për të punësuarit në sektorin publik respektivisht fushën e arsimit ndaj të cilëve nuk aplikohet legjislacioni i shërbimit civil, ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin civil rregullohen me legjislacion të shërbimit civil përkatësisht Ligjin e Zyrtarëve Publik Nr.06/L-114, Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë prandaj mbi këtë bazë pretendimet e ankuesve janë të pabazuara.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) ka juridiksionin që të siguroj respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, përmes ushtrimit funksioneve të përcaktuar me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku theksohet se : *Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;... 1.3 monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil,* Andaj në vështrim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë se Këshilli nuk ka juridiksion që të shqyrtoj rregullat dhe parimet jashtë shërbimit civil respektivisht Kolegji vlerëson së aktet juridike mbi të cilat ankuesi ka bazuar pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me fushëveprimin e legjislacionit të shërbimit civil, kështu që trajtimi i çështjes ankimore bazohet vetëm në kuptim të legjislacionit të shërbimit civil, Ligjin e Zyrtarëve Publik Nr.06/L-114 ,Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë. Andaj bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se marrëdhënia e punës e ankuesve është e themeluar në bazë të legjislacionit të shërbimit civil në fuqi dhe çdo ankesë apo kërkesë duhet të bëhet konform dispozitave ligjore të cilat aplikohen për të punësuarit me statusin e nëpunësve civil konformë legjislacionit të shërbimit civil.

Siç u tha me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.563/2022, datë 05/08/2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Av.
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të rritur;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të rritur;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

